

# Ju dëshironi të ftoni dikë për vizitë?

Për këtë duhet të paraqiteni personalisht pranë zyrës së të huajve dhe të jepni deklaratën e garancisë.

Për këtë nevojiten dokumentet e mëposhtme:

- **Pasaporta e vlefshme / Letërnjoftimi i ftuesit**
- **Të dhënat e personit, që dëshironi të ftoni**  
(Mbiemri, emri, ditëlindja, vendlindja, nënshtetësia, adresa, mundësisht edhe numrin e pasaportës)
- **Dëshmi aktuale mbi të ardhura të mjaftueshme**  
(tre rrogat apo listën e pagave, për të pavarurit deklaratën e tatimeve apo deklaratën e fitim dhe humbjeve gjegjësisht bilancin e muajve të fundit, vërtetim pensioni)
- **Dëshminë mbi hapësirën e mjaftueshme të banimit**  
(kontratën e qirasë (nëse është më e vjetër se 4 vjet, pasqyrën aktuale bankare) / kontratën e blerjes ose ekstrakt nga regjistri i pasurive të paluajtshme pranë Gjykatës Themelore, deklaratë bankare mbi kredinë)
- **29,00 € pagesë**

Mikpritësi duhet të paraqitet personalisht **në takim** me zyrën e të huajve si edhe të nënshkruaj deklaratën e garancisë para nëpunësit përkatës. Formularët nuk mund të merren me vete në shtëpi. Nënshkrimi i deklaratës së garancisë është i mundur vetëm, nëse vendbanimi juaj kryesor gjindet nën juridiksionin territorial të Qarkut Freising. Nëse ju nuk jeni nënshtetas/e gjerman, ju duhet të zotëroni një leje-qëndrimi të sigurt në Gjermani (Jo Duldung! (leje për qëndrim të toleruar)).

Deklarata e garancisë përfshinë, mbulimin e pagesave të të gjitha mjeteve publike, të cilat janë të domosdoshme për shpenzimet jetësore duke përfshirë sigurimin e hapësirës për banim dhe përkujdesin në rast sëmundjeje dhe në rast përkujdesi spitalor (p.sh. vizitat te mjeku, ilaçet, qëndrimet/vizitat në spital). Kjo vlen edhe në rastet kur shpenzimet bazohen në të drejta ligjore (p.sh. përfitime sociale në bazë të librit të dytë dhe të dymbëdhjetë të Legjislacionit Social ose të Legjislacionit për Azilkërkuesit) për dallim nga shpenzimet, të cilat bazohen në pagesën e një kontributi.

Deklarata e garancisë për mbulimin e shpenzimeve në rast sëmundjeje, e le të pa cenuar detyrimin e të huajit, të paraqes një sigurim shëndetësor adekuat pranë përfaqësisë përkatëse Gjermane.

Deklarata e garancisë përfshin gjithashtu edhe shpenzimet e udhëtimit të të ftuarit (p. sh. biletën e fluturimit). Përveç kësaj, deklarata e garancisë përfshinë edhe mbulimin e shpenzimeve në rast ndërprerjeje të detyruar të leje-qëndrimit p.sh. në rast dëbimi apo deportimi sipas neneve §§ 66 dhe 67 të ligjit për të drejtën e rezidencës. Këtu përfshihen p.sh. shpenzimet e transportit dhe udhëtimi në destinacionin e vendit të huaj, eventualisht edhe shpenzimet e nevojshme për shoqërimin, përkthimin, ushqimin dhe paraburgimin.

Kërkesën për mbulimin e shpenzimeve kundër personit që lëshon deklaratën e garancisë, e parashtron institucioni zyrtar, i cili ka shpenzuar dhe vënë në dispozicion mjetet publike për të huajin/ të huajën (neni § 68 paragrafi 2 alineja 3 e ligjit për të drejtën e rezidencës).

Informacionet e mëtejshme mund t'i mirrni nga nëpunësit përkatës.

**Zonja Klein, zyra 711, Tel.: 08161/600-816**

**Zonja Falkenstein, zyra 713, Tel.: 08161/600-646**

**Zonja Schweiger, zyra 713, Tel.: 08161/600-646**

**Zonja Steinbach, zyra 713, Tel.: 08161/600-664**